



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.1955/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1955/2025, të datës 27.11.2025, të parashtruar nga ankuesja D.H, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/ Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*masë disiplinore-vërejtje me shkrim*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.1955/2025, e datës 27.11.2025, e parashtruar nga ankuesja D.H.

II. Anulohet “*Vërejtja me shkrim*” me numër protokolli 8095/25 e datës 04.11.2025, e shqiptuar ndaj ankuses, nga Ushtruesja e Detyrës e Udhëheqëses së Divizionit për Autorizime dhe Licenca në kuadër të Departamentit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri.

III. Obligohet Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të tij, duke larguar nga dosja personale masën disiplinore ndaj ankuses në pajtim me pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, D.H (*tutje referuar* ankuesja), me datë 27.11.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 7600/2025, në Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vërejtjes me shkrim me numër protokoli 8095/25 të datës 04.11.2025, të shqiptuar nga Ushtruesja e Detyrës së Udhëheqëses së Divizionit për Autorizime dhe Licenca në kuadër të Departamentit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (*tutje referuar* MMPHI), ndërsa, kjo e fundit më 19.12.2025, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*tutje referuar* Kolegji i Këshillit), administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 7600/2025 të datës 27.11.2025; Vërejtjen me shkrim me numër protokoli 8095/25 të datës 04.11.2025; Vendimin A.nr.1425/2025 të datës 06.11.2025; Letërnjoftimin e ankueses; Kërkesën përgjigje në ankesë të datës 11.12.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 19.12.2025; E-mailin e datës 07.07.2025, me korrespondim prej 4 faqeve; E-mailin e datës 26.11.2025; Vendimin për aprovim të pushimit të datës 27.11.2025; Vendimin për refuzim të pushimit të datës 26.11.2025; Vendimin për aprovim të pushimit të datës 04.07.2025; E-mailin e datës 25.09.2025, me korrespondim prej 2 faqeve; Dosja e pushimit vjetor të ankueses për vitin 2025; Detajet e pushimit vjetor të ankueses, për vitin 2025; Formularët e vlerësimit të punës të ankueses, të datës: 22.01.2023, 21.01.2023; Raportin e vijueshmërisë; Vendimin me numër protokoli 5225-2/25 të datës 19.11.2025; Vendimin me numër protokoli 5225/25 të datës 04.07.2025; Vendimin me numër protokoli 09/25 të datës 06.01.2025; Vendimin me numër protokoli 4440/24 të datës 08.07.2024; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 01.04.2018; Vendimin me numër protokoli 6658/23 të datës 10.11.2023; Përshkrimin e detyrave të punës, të datës 31.10.2013; Akt emërimit me Nr.prot.181/2014 të datës 04.03.2014, me përshkrimin e detyrave të punës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankueses konstatoi se ankesa **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt emërimit me Nr.prot.181/2014 të datës 04.03.2014, është punësuar në pozitën **Zyrtar Administrativ** në Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, ndërsa, sipas Vendimit me numër protokoli 6658/23 të datës 10.11.2023, është transferuar në mënyrë të përhershme në pozitën e **Zyrtares së Lartë për Licencim** në kuadër të Departamentit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore.

Më tej nga shkresat e lëndës rezulton se Ushtruesja e Detyrës së Udhëheqëses së Divizionit për Autorizime dhe Licenca, për shkak të shkeljeve të përsëritura gjatë kohës së punës, mungesës së pa

arsyetim në vendin e punës dhe sjelljes së papërshtatshme me mbikëqyrësen, me datë 04.11.2025 i ka shqiptuar ankueses masën e lehtë disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”, me numër protokolli 8095/25.

Ankuesja, kundër vërejtjes me shkrim me datë 27.11.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke theksuar se edhe pse Këshilli si organ mbikëqyrës ka konstatuar se vendimi për emërimin e Ushtrueses së Detyrës së Udhëheqëses të Divizionit për Autorizime dhe Licenca ka qenë i jashtëligjshëm, të njëjtës ende i figuron se ka masë disiplinore e shqiptuar nga e njëjta zyrtare në dosjen personale, rrjedhimisht kërkon ndërmarrjen e hapave të nevojshëm që vërejtja e jashtëligjshme të fshihet nga dosja e ankueses dhe të korrigjohet plotësohet situata juridike dhe administrative.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se shqiptuesja e masës disiplinore zyrtarja F.B, sipas Akt emërimit të datës 01.04.2018, mbanë pozitën e **Zyrtares për Vlerësimin e ndikimit të Gjendjes në Mjedis**, në Divizionin/Drejtorinë për Gjendjen e Mjedisit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Ndërsa, e njëjta sipas Vendimit me numër protokolli 4440/24 të datës 08.07.2024, të Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, është caktuar në cilësinë e **Ushtrueses së Detyrës së Udhëheqëses së Divizionit për Autorizime dhe Licenca në Departamentin për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore**, dhe atë nga data 03.07.2024 deri më 20.01.2025, me mundësi vazhdimi sipas legjislacionit në fuqi, i cili vazhdim rezulton se është realizuar përmes Vendimit me numër protokolli 09/25 të datës 06.01.2025, për periudhën nga data 03.01.2025 e deri më 02.07.2025.

Më tej, përmes Vendimit me numër protokolli 5222/25 të datës 04.07.2025, të Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, rezulton se zyrtarja e lartë theksuar F.B, përsëri nga pozita e Zyrtares për Vlerësimin e ndikimit të Gjendjes në Mjedisit, në Divizionin/Drejtorinë për Gjendjen e Mjedisit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, është caktuar në cilësinë e Ushtrueses së Detyrës në pozitën e njëjtë të kategorisë së ulët drejtuese, atë të Udhëheqëses së Divizionit për Autorizime dhe Licenca në Departamentin për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, me efekt juridik nga data 03.07.2025 deri më 02.07.2026.

Mirëpo, mbi bazën e të dhënave që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës posedon për ankesat e vendosura dhe atyre në shqyrtim, rezulton se ankuesja për shkak të pakënaqësisë së qasjes dhe veprimeve administrative nga Ushtruesja e Detyrës së Udhëheqëses së Divizionit për Autorizime dhe Licenca në Departamentin për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, me datë 22.07.2025 ka parashtruar ankesë ndaj aktit administrativ të lartë theksuar, gjegjësisht Vendimit me numër protokolli 5225/25 të datës 04.07.2025 U.D Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, për caktimin e së njëjtës në cilësinë e U.D të Udhëheqëses së Divizionit për Autorizime dhe Licenca, me datë efektive nga 03.07.2025 e deri me datë 02.07.2026, me pretendimet ankimore se e njëjta nuk ishte njoftuar nga organi i punësimit për veprimet e ndërmarra ashtu që është caktuar një zyrtare në cilësi të ushtrueses së detyrës në një pozitë nga tjetër njësi organizative institucionale, duke pretenduar ndër të tjera se këto veprime bien ndesh nga me dispozitat e aplikuara nga neni 35 të Ligjit Nr.08/L-187 për Zyrtarët Publik,

si dhe me Rregulloren (ZKM) Nr.08/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MMPHI-së, pasi që zyrtarja F.B e caktuar në cilësi të Ushtrueses së Detyrës të Udhëheqëses së Divizionit për Autorizime dhe Licenca, nuk është e punësuar me pozitë as në kuadër të Divizionit për Autorizime dhe Licenca dhe as në kuadër të Departamentit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, mirëpo e njëjta zyrtare është e punësuar në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Si rrjedhojë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes zyrtares përgjegjëse të caktuar për ankesën e ankueses së datës 22.07.2025, të protokolluar me numër 4874/2025 dhe regjistruar nën shenjë A.nr.1425/2025, përmes e-mailit të datës 19.08.2025, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek organi përkatës i punësimit, në këtë rast Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Duke bashkangjitur me këtë rast në formatin PDF edhe ankesën e ankueses, rrjedhimisht, duke njoftuar këtë të fundit se ndaj Vendimit me numër protokolli 5225/25 të datës 04.07.2025 U.D Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, është parashtruar ankesë, gjegjësisht përveç njoftimit lidhur me këtë çështje dhe provave të kërkuara, Këshilli, me këtë rast ka njoftuar dhe sqaruar organit të punësimit se: *Duke marrë për bazë dispozitat e nenit 130 paragrafi 1 dhe nenit 144 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ju bëjmë me dije se aktet ndaj të cilave parashtrohet ankesë në Këshill, nuk mund të ekzekutohen pasi që sipas fuqisë së ligjit, parashtrimi i një ankese pezullon sipas fuqisë së ligjit prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën.*

Andaj, Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, bazuar në atë që u theksuar si më sipër dhe shkresat e bashkangjitura e lëndës konstaton se masa disiplinore *Vërejtje me shkrim* me numër protokolli 8095/25 e datës 04.11.2025, e shqiptuar ndaj ankueses, nga Ushtruesja e Detyrës së Udhëheqëses së Divizionit për Autorizime dhe Licenca, është në kundërshtim me dispozitat e nenit 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ndërlidhur me nenin 144 paragrafin 1 të të njëjtit ligj ku është përcaktuar në mënyrë taksative se kur një akt administrativ bëhet i ekzekutueshëm, respektivisht është përcaktuar se: *Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës;*, ngase në rrethanat e rastit konkret, ashtu siç u theksua edhe më sipër organi gjegjësi ka qenë i njoftuar përmes kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 19.08.2025, se ndaj Vendimit me numër protokolli 5222/25 të datës 04.07.2025, të Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, për caktimin në këtë rast të shqiptueses së masës së lehtë disiplinore *Vërejtje me shkrim*, në cilësinë e Ushtrueses së Detyrës Udhëheqëses së Divizionit për Autorizime dhe Licenca, është parashtruar ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga rrjedhë se në rastin konkret nuk është plotësuar asnjëri nga parakushtet ligjore për ndërmarrjen e veprimeve

përkatëse ndaj ankueses, ngase zyrtarja F.B. në këtë cilësi të ushtrimit të pozitës sipas akti të kontestuar me ankesë e në respektim e zbatim të këtyre dispozitave ligjore, është dashur që ti pezulloj veprimet juridike administrative, ndërsa, faktikisht e njëjta brenda periudhës kohore të procedurës së shqyrtimit të ankesës së datës 22.07.2025 nga Këshilli, përkatësisht me datë 04.11.2025, i ka shqiptuar ankueses masë të lehtë disiplinore.

Ndërlidhur, me ankesën e parashtruar nga ankuesja me datë 22.07.2025, kundër Vendimit me numër protokolli 5222/25 të datës 04.07.2025, të Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, për caktimin Ushtrueses së Detyrës të Udhëheqëses së Divizionit për Autorizime dhe Licenca, në këtë rast edhe shqiptueses së Vërejtjes me shkrim me numër protokolli 8095/25 të datës 04.11.2025, vlen të theksohet se, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pas konstatimit se akti i kontestuar me ankesë për caktimin e zyrtares së njëjtë F.B. në cilësinë e ushtrueses së detyrës në pozitën përkatëse është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, përkatësisht nenit 35 paragrafit 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe dispozitat e aplikuara nga neni 52 paragrafi 1, nënë paragrafi 1.5 dhe 1.6 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, përmes Vendimit A.nr.1425/2025 të datës 06.11.2025, ka aprovuar ankesën e ankueses, rrjedhimisht, ka anuluar Vendimin me numër protokolli 5222/25 të datës 04.07.2025, të Ushtruesit të Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, duke obliguar këtë të fundit për ndërmarrjen e të gjitha veprimet e nevojshme juridike për zbatimin e këtij vendimi, i cili vendim rezulton se është zbatuar nga ky i fundit sipas Vendimit me numër protokolli 5225-2/25 të datës 19.11.2025.

Andaj, duke qenë se me provat e administruara është vërtetuar mjaftueshëm se masa disiplinore *Vërejtje me shkrim*, me numër protokolli 8095/25 e datës 04.11.2025, e shqiptuar ndaj ankueses nga Ushtruesja e Detyrës së Udhëheqëses të Divizionit për Autorizime dhe Licenca, është shqiptuar gjatë periudhës kohore të shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesja në Këshill, kundër vet aktit të caktimit të së njëjtës në këtë pozitë të kategorisë së ulët drejtuese, e që më pas i njëjti ka rezultuar si i kundërligjshëm, Kolegji i Këshillit, konstaton se akti i kontestuar me ankesë është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, paragrafit 4 si dhe me nenin 144 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 58 paragrafit 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, për faktin e konstatuar tani më se zyrtarja F.B. nuk ka autorizim ligjor në raport të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të ankueses, rrjedhimisht edhe shqiptimit të masave të lehta disiplinore.

Si rrjedhojë e kësaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se akti i kontestuar me ankesë është paligjshëm në kuptim të nenit 52 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndaj me qëllim të kthimit të ligjshmërisë në mbështetje të nenit 53 paragrafi 2 dhe nenit 55 paragrafi 1 të këtij ligji, Kolegji i Këshillit, vendosi për anulimin e *Vërejtjes me shkrim*, me numër protokolli 8095/25 e datës 04.11.2025, të shqiptuar ndaj ankueses nga Ushtruesja e Detyrës së Udhëheqëses të Divizionit për Autorizime dhe Licenca, me obligimin ligjor që Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MMPHI, të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi ashtu që të bëjë largimin nga dosja personale te masës disiplinore te shqiptuar ndaj ankueses në pajtim me arsyetimin dhe konstatimin e këtij vendimit.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 4 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1955/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses D.H;*
- *Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MMPHI; si dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*